

Atij që i takon

Lozanë, qershor 2023

Nuk keni zgjidhje për fillimin e vitit të ri shkollor ?

Zonjë, Zotëri, të dashur Prindër,

Fëmija juaj e ka mbaruar shkollimin e detyrueshëm dhe nuk ka gjetur një vend formimi ose nuk i ka pikat për në gjimnaz a klasë rakordimi ? Ejani të takoni këshilltaren apo këshilltarin e tij në fushën e orientimit për të diskutuar për një zgjidhje për të ardhmen, për shembull një masë tranzitimi (Ecole de la transition, SeMo) që do ta ndihmojë fëmijën tuaj në gjetjen e një vend formimi.

1. **Çfarë është një masë tranzitimi ?**
për të ditur se çfarë është një masë tranzitimi

klikoni këtu ► www.vd.ch/transition



2. **Si bëhet regjistrimi në një masë tranzitimi ?**

Regjistrimi bëhet gjatë një bisede me një këshilltare apo këshilltar në fushën e orientimit.

1. **Nga 19 qershori deri në 7 korrik 2023**, bisedë me një këshilltare apo këshilltar në fushën e orientimit të institucionit shkollor të fëmijës suaj duke thirrur numrin e shënuar në shkresën frëngjisht që keni marë.
2. **Duke filluar nga 9 korriku 2023**, bisedë me një këshilltare apo këshilltar në fushën e orientimit në dispozicion në qendrën rajonale të orientimit duke thirrur numrin e shënuar në shkresën frëngjisht që keni marë ose duke marë takim drejtpërdrejt në linjë : www.vd.ch/transition.

Me rastin e këtij takimi, fëmija juaj duhet të marë me vete :

- Një kopje të librezës së notave më të fundit
- Cv-në e tij (curriculum vitae)

Prania e prindërve është e dëshirueshme dhe e rekomandueshme !

Duke ju falënderuar për vëmendjen që i kushtoni kësaj shkrese, ju drejtojmë, Zonjë, Zotëri, të dashur Prindër, përshëndetjet tona më të mira.

Office cantonal d'orientation scolaire
et professionnelle
[Zyra kantonale e orientimit shkollor
e profesional]

- ▶ Përkthimin e kësaj letre mund ta gjeni në sitin e orientimit :
- ▶ Eine Übersetzung dieses Schreibens finden Sie auf der Website der Berufsberatung :
- ▶ You can find a translation of this letter on our Website :

◀ تتوافر الرسائل المترجمة إلى عدة لغات على موقعنا الإلكتروني :

- ▶ Podrá encontrar una traducción de esta carta en nuestro sitio web :
- ▶ Troverete una traduzione di questa lettera sul sito di orientamento :
- ▶ Podem também encontrar uma tradução desta carta no nosso sítio de internet :
- ▶ Prevod ovog pisma se nalazi na našoj veb strani :
- ▶ እዚ ዝተተርጎመ ደብዳቤ ኣብ ናይ ምምካር ሞያ መርበብ ኣብሬታ ክትረኽቡዎ :
- ▶ Bu mektupların değişik dillerde çevirilerini İnternet sitemizde bulabilirsiniz :
- ▶ Ви можете ознайомитися з перекладом цього листа на нашому сайті :

Les lettres traduites dans différentes langues sont disponibles via le site internet en scannant le code QR avec votre appareil photo :

- ▶ www.vd.ch/orientation
▶ rubrika **Publications, voir tout en bas**

